

## **RELACION**

### **PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 712, DATË  
31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E  
PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E  
PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA TË  
PESHKIMIT NË DET, PA PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUOSE,  
DHE ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE,  
TOKËSORE DHE UJORE”, TË NDRYSHUAR**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është qartësimi dhe përmirësimi i procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruose dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore.

Gjithashtu, objektivi i hartimit të këtij projektvendimi është të lehtësojë dhe të përshpejtojë procedurat për dhënien e të drejtës për të ushtruar aktivitetin e zhvillimit në ujërat e brendshëm, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe mirëmenaxhimin e këtyre sipërfaqeve ujore.

### **II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTË TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin Analistik të Projektakteve që do miratohen nga Këshilli i Ministrave në vitin 2025, por hartohet dhe synohet miratimi gjatë këtij viti.

### **III. ARGUMENTIMI LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 712/2013, të ndryshuar, aktualisht në fuqi, dhënia e të drejtës për peshkimin në ujërat e brendshme, si dhe procedura e konkurrimit publik realizohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

1

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruose, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore”, të ndryshuar.

Në vitin 2015, nëpërmjet VKM-së Nr. 1108/2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujites dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rjonale të kullimit”, ujëmbledhësat/rezervuarët e bujqësisë u transferuan nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural tek pushteti vendor. Në vijim, duke qenë se këto sipërfaqe ujore janë transferuar në bashkitë respektive, është më efektive që procedurat e konkurrimit publik dhe monitorimi i tyre në vazhdimësi të zhvillohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Hartimi i këtij projektvendimi synon:

- Rritjen e efektivitetit dhe mirëmenaxhimin e këtyre sipërfaqeve ujore;
- Lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave të zhvillimit të konkurrimit publik në kuadër të procesit të derregullimit;
- Forcimi i rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore për administrimin e objekteve ujore në territorin e tyre.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 52, të Ligjit Nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe në harmoni me legjislacionin vendas.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËSSË PËRAFRIMIT ME ACQUISE BE-SË**

Projektvendimi nuk kryen përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Projektvendimi përbëhet nga 11 pika.

*Pika 1* parashikon shfuqizimin e pikave 11/1, 12 dhe 12/1.

Këto pika propozohen të shfuqziohen për arsyse procedura e konkurrimit publik për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujëmbledhësat e bujqësisë, parashikon të zhvillohen nga bashkia, nën juridikcionin e së cilës ndodhet ky objekt ujor.

*Pikat 2 dhe 3 parashikojnë ndryshime në pikat 13 dhe 14 që lidhen me procedurën që ndjek Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave.*

*Pika 4 parashikon riformulimin e pikës 15 duke theksuar se kontrata lidhet nga titullari i institucionit, pra ministri ose bashkia përkatëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të afatit të ankimit.*

*Pika 5 parashikon disa rregullime në pikat 16 dhe 16/1 për formatin tip të kontratës dhe monitorimin e saj, institucioni përgjegjës.*

*Pikat 6, 7 dhe 8 parashikojnë rregullime në dispozitat që lidhen me procedurën e ankimit si përcaktimi i afatit dhe ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave duke përcaktuar qartë dhe detyrat e këtij komisioni.*

*Pika 9 parashikon rregullimin e pikës 18 duke saktësuar se afati i kontratës për ushtrimin e veprimtarisë është në çdo rast 10 vjet.*

*Pika 10 parashikon se procedurat e parashikuara në pikat 5, 5/1, 5/2, 11, 12/2, 13, 14, 15, 16/1, 17/1, 17/2 dhe 18 të vendimit do të zhvillohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nën juridikcionin territorial të së cilës ndodhet ujëmbledhësi i bujqësisë.*

*Pika 11 parashikon institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.*

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT**

Projektvendimi u hartua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projektvendimi dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

*Ministria e Financave* është shprehur parimisht dakord.

*Ministri për Shtetin* dhe *për Pushtetin Vendor* është shprehur dakord me sugjerimin për ta dërguar në Këshillin Konsultativ për Qeverisje Qendrore dhe Vetëqeverisjen Vendore. Ky projektvendim do të niset për mendim dhe miratim në këtë këshill.

*Ministria e Drejtësisë* është shprehur me disa komente.

Projektvendimi është ripunuar duke ndryshuar bazën ligjore për arsyen në ndryshimet e këtij vendimi në vitin 2019 është përfshirë edhe zhvillimi i procedurës së konkurrimit publik për aktivitetin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore. Kjo bazuar në nenin 17, të Ligjit Nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i cili citon se: “*Forma e aplikimit, ngritja e komisionit të vlerësimit, procedura e konkurrimit, dokumentet që subjektet paraqesin për të marrë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, ankimi, si dhe lloji e përbajtja e kontratës që lidhet ndërmjet palëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Duke qenë se, sipas ligjit për akuakulturën përvçe fitimit të së drejtës për aktivitetin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, objekt i konkurrimit publik mund të jenë edhe instalimet në pronësi shtetërore. Duke qenë se në vendimin në fuqi nuk është parashikuar shprehimi i procedura e konkurrimit për këto instalime, është e nevojshme që në funksion të qartësisë të plotësohet dhe ky vakum ligjor.

Në lidhje me *komentin 1*, sqarojmë se është reflektuar duke ripunuar në tërsi pikën 5 të projekvendimit, lidhur me procedurën që ndiqet nga komisioni i vlerësimit të kërkesave.

Në lidhje me *komentin 2*, sqarojmë se qëllimi i këtij ndryshimi konsiston në zëvendësimin e ministrit, si autoriteti që lidh kontratën, me titullarin e institucionit për shkak se kontratat për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në ujëmbledhësat e bujqësisë do të lidhen nga kryetari i bashkisë përkatëse.

Në lidhje me *komentin 3*, sqarojmë se kontrata tip është propozuar të miratohet nga ministri përgjegjës për peshkimin sepse ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, dhe si e tillë përcakton rregullat e zhvillimit të këtyre aktiviteteve në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me *komentin 4*, sqarojmë se është reflektuar.

Në lidhje me *komentin 5*, sqarojmë se është reflektuar duke u rishikuar afati i shqyrtimit të ankimit. Gjithashtu, sqarojmë se për një procedurë konkurrimi ku mund të ketë më shumë se një ankesë, komisioni është i detyruar të presë dhe të shqyrtojë njëherazi të gjitha ankimet e mundshme por të marrë vendime të veçanta për secilën prej tyre.

Në lidhje me *komentin 6*, sqarojmë se është reflektuar.

Në lidhje me komentin 7 dhe 8, sqarojmë se sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, ministria përgjegjëse për peshkimin mund të autorizojet organet administrative ose entet e tjera për dhënien e së drejtës së peshkimit, të parashikuara në këtë ligj.

Aktualisht, procedura e konkurrimit publik për dhënien e së drejtës së peshkimit në ujëmbledhësat e bujqësisë zhvillohet nga MBZHR.

Pasi Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shpall fituesit, subjekti përpara lidhjes së kontratës duhet të nënshkruajë një marrëveshje për shfrytëzimin e ujit, pasi këto objekte ujore si funksion primar kanë sigurimin e ujut për ujitje, dhe më pas, përdorimi i tyre për peshkimin.

MBZHR me anë të këtij projektvendimi synon lehtësimin e procedurave për fitimin e së drejtës së peshkimit në ujëmbledhësat e bujqësisë, fillimisht duke përshpejtuar dhe efektivizuar procesin e konkurrimit publik, në mënyrë që çdo bashki të mund të shpallë për konkurrim në mënyrë të pavarur ujëmbledhësat në administrimin e saj, ndërkohë që në vendimin aktualisht në fuqi, çdo proces konkurrimi zhvillohet vetëm nga MBZHR, çka e bën procesin e centralizuar dhe jo eficient.

Gjithashtu, siç u përmend edhe më sipër, funksioni primar i këtyre objekteve ujore është sigurimi i ujut për ujitje, dhe më pas përdorimi i tyre për peshkim.

Bashkia, në autonominë e saj mund të vendosë të shpallë ose jo për konkurrim një ujëmbledhës lidhur kjo me përshatshmërinë e tij për të zhvilluar aktivitet peshkimi, gjendja teknike e objektit ujor, dhe nevojat e zonës për rezerva ujore për vaditje.

Kontrata tip që do të hartohet nga MBZHR për të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit në ujëmbledhësat e bujqësisë do të integrojë edhe elemente të marrëveshjes për përdorimin e ujit, që aktualisht lidhet midis subjekteve fitues edhe bashkive.

Kjo kontratë do të nënshkruhet nga kryetari i bashkisë përkatëse dhe do të ketë në përbajtje të saj, si rregullat për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit, ashtu edhe rregullat për shfrytëzimin e ujit. Kontrata në fjalë do të dërgohet për mendim dhe miratim në Këshillin Konsultativ për Qeverisje Qendrore dhe Vetëqeverisjen Vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

